



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Nr. Prot: 07-\_\_\_\_\_

Datë: 14.08.2026

Deçan



Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 17, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal për klasë dhe raportin mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASH, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Deçan shpall:

## KONKURS PLOTËSUES

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE INSTITUCIONIN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP) PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027**

### I. GJIMNAZI "VËLLEZËRIT FRASHËRI" NË DEÇAN

| Drejtimi             | Numri i paralave dhe nxënësve | Gjithsej nxënës   |
|----------------------|-------------------------------|-------------------|
| Shkenca Natyrore     | 2 x 20                        | 40 nxënës         |
| Shoqëroro - Gjuhësor | 3 x 20                        | 60 nxënës         |
| <b>GJITHSEJ</b>      | <b>5 paralele</b>             | <b>100 nxënës</b> |

## II. INSTITUCIONI I ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP) "TAFIL KASUMAJ" NË DEÇAN

| Drejtimi                                            | Profili Arsimor                  | Numri i nxënësve   |
|-----------------------------------------------------|----------------------------------|--------------------|
| Agrokulturë, Pylltari,<br>Peshkatari dhe Veterinari | Hortikulturë                     | 1 x 18 = 18 nxënës |
| Shërbime                                            | Asistent i mirëpritjes hoteliere | 1 x 12 = 12 nxënës |
|                                                     | Kuzhinier                        | 1 x 18 = 18 nxënës |
| <b>GJITHSEJ</b>                                     | <b>3 profile</b>                 | <b>48 nxënës</b>   |

## III. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE TË RREGULLT

1. Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të të Gjimnazit dhe të IAAP-së për vitin shkollor 2026/2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
2. Nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

## IV. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR KONKURRIM

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron);
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (klasat 6-9);
- Certifikatën e lindjes.

## V. AFATI I PARAQITJES SË DOKUMENTEVE DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

- **Paraqitja e dokumenteve:** Bëhet me datën **17, 18 dhe 19 GUSHT 2026** në lokalet e shkollës amë ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora **08:00 deri në 16:00**.

- **Shpallja e rezultateve:** Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **20.08.2026**.

## VI. PROCEDURA E ANKESAVE

1. Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditëve pune nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës.
2. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy (2) ditëve pune pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.
3. **Vërejtje:** Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar në shkollën përkatëse nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkallën e dytë në DKA apo në MASH. DKA dhe MASH nuk shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo nuk është shqyrtuar fillimisht nga komisioni përkatës i shkollës.

## VII. KRITERET PËR REGJISTRIM

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

| Nr. | Kriteri                                  | Përqindja / Pikët      |
|-----|------------------------------------------|------------------------|
| 1   | Suksesi nga shkollimi i obliguar         | 40% (40 pikë)          |
| 2   | Suksesi nga lëndët me prioritet në test  | 20% (20 pikë)          |
| 3   | Numri i pikëve nga testi i arritshmërisë | 40% (40 pikë)          |
|     | <b>GJITHSEJ</b>                          | <b>100% (100 pikë)</b> |

Nxënësi maksimalisht mund të fitojë 100% të pikëve.

**Drejtori i DKA-së:**

Besnik Alulaj

